



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1352, datë 06.08.2010

Per

“Fillimin e procedimit administrativ per zgjidhjen e mosmarreveshjes per moslidhje marreveshje interkoneksioni midis Mobitel WLS shp.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Anilda Mulgeci , në mbledhjen e datës 06.08.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis Mobitel WLS sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 66-104 te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010;
4. Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 416, date 07.12.2007, e ndryshuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Mobitel WLS sh.p.k me shkresen nr. 2596 prot, date 8.07.2010 i është drejtuar AKEP me ankesen për të zgjidhur mosmarreveshjen mes paleve për moslidhjen e MI-se, duke filluar një procedim administrativ nga AKEP, për urdherimin e Albanian Mobile Communications sh.a (në vijim AMC) për të lidhur marreveshje interkoneksioni me Mobitel WLS sh.p.k., duke vënë në dispozicion të AKEP gjithë informacionin në lidhje me korespondencën e shkresave me AMC si më poshtë vijon:

- a. Shkresë e Mobitel WLS extra prot , date 18.03.2010 ;
- b. Vijuar me shkresen nr. 18, date 02.04.2010 ;
- c. Shkresë e Mobitel WLS extra prot , date 19.05.2010;
- d. Vijuar me shkresen nr. 34, date 10.06.2010.

2. Sipas Mobitel në vitin 2009, AMC sh.a ka ndërprerë marreveshjen e interkoneksionit me Mobitel pas një kushtezimi finaciare duke i kërkuar tarifën për marreveshjen e interkoneksionit 190 000 leke në muaj. Mobitel në këtë ankim sqaron AKEP-in për vështirësinë e abonenteve për të kryer thirrje drejt rrjetit AMC si dhe për mënyrën e bashkpunimit që i ofron AMC-se nga ana teknike për të zgjidhur mosmarreveshjen e interkoneksionit ku AMC nuk i është përgjigjur për të bashkëpunuar.

3. AKEP me shkresen nr.2596/1 prot, date 23.07.2010 drejtuar Sipermarresit Mobitel, ku ndër të tjera e sqaron Mobitel se ankesa e bërë për mosmarreveshjen për të rilidhur marreveshjen e interkoneksionit me AMC është në formën e kërkuar për procedurat e zgjidhjeve të mosmarreveshjeve të interkoneksionit, por mungojnë provat e dokumentuara në të cilën është bazuar ankimi i bërë për rilidhje të marreveshjes interkoneksionit me AMC, për këtë arsye AKEP i kërkon Mobitel të rihartoje ankimin me prova të dokumentuara sipas formës së kërkuar në rregulloret dhe ta dergojë në AKEP deri më datën 26.07.2010.

4. Mobitel me shkresen nr.46 prot, date 27.07.2010 i përgjigjet AKEP për shkresen nr. 2596/1 prot, date 23.07.2010 për rihartimin e ankimit për rilidhje të marreveshjes interkoneksionit me AMC, duke paraqitur provat e kërkuara nga AKEP. Në ankimin e ridërguar në shkresën e cituar më lartë, Mobitel e arsyton në:

- a. mos përgjigjen e shkresave të Mobitel nga AMC për rilidhjen e marreveshjes interkoneksionit

- b. mos ndryshimi I AMC ne mardhenjet mosmarreveshese me Mobitel pas ankimit ne AKEP
- c. mos ndryshim te fakteve te paraqitura me pare nga Mobitel ne AKEP
- d. VKD nr. 1345, date 23.07.2010 te AKEP qe detyron AMC-ne te jape interkoneksion
- e. kerkest e Mobitel drejtuar AMC-se per rilidhje te marrveshjes interkoneksionit jane te bazuara ne ligje dhe ne rregulloret e AKEP-it.

5. Mobitel Wireless shkreses se lartecituar i ka bashkengjitur shtojcen e marreveshjes se interkoneksionit midis AMC – Mobitel nr.46 prot, date 13. 03. 2008, amendamentin nr. 2 i marreveshjes interkoneksionit date 01.11.2007, dhe korespondencen shkresore te derguar AMC-se per rilidhje te marreveshjes interkoneksionit.

6. Pavaresisht te gjitha perpjekjeve per te negociuar me sipermarresin AMC palet nuk kane arritur te lidhin marreveshjen e interkoneksionit si rezultat i refuzimit te AMC per t'iu pergjigjur shkreses se Mobitel WLS “ Kerkohet rilidhja e marreveshjes se Interkoneksionit” me date 10.06.2010 kerkese te cilen e mbeshtetet ne nenin 50 dhe 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes se mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresit Mobitel WLS sh.p.k dhe AMC sh.a, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 i Rregullores “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve” si dhe pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme te AKEP, e ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të filloje procedimin administrativ, per zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresit Mobitel WLS sh.p.k dhe AMC sh.a;
2. Te ngrihet komisioni per zgjidhjen e mosmarreveshjeve me perberje si:

- Edlira Vatnikaj Kryetare
- Florida Çela Anetar
- Enkeleda Bega Anetar
- Ded Jakaj Anetar

3. Palet te depozitojne pretendimet dhe provat shkresore te tyre deri me 20.08.2010;
4. Të njoftohen palët e interesuara per kete vendim;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi ne daten e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**